



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 8/6 Prot

Tiranë, më 18/03/2015

V E N D I M

Nr. 05, datë 18/03/2015

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, si dhe Ligjin Nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Hetimit Administrativ në ngarkim të kontrolluesit "Stock International Albania" sh.a, Tiranë regjistruar pranë QKR-së me NIPT L 42228036 E,

V Ë R E J S E :

Në zbatim të Urdhrit Nr.223 , datë 04.12.2014, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është ushtruar kontroll administrativ pranë kontrolluesit, "Stock International Albania" sh.a, me objekt: *Zbatimi nga ana e kontrolluesit i Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, gjatë kryerjes së aktivitetit të tij.*

Kontrolluesi, "Stock International Albania" sh.a, Tiranë ka si objekt veprimtarie, të deklaruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR), prezantimin e brokerave që operojnë në fushën e aksioneve dhe letrave me vlerë, duke informuar klientët në lidhje me opsionet e mundshme që kanë në këtë fushë. Kryen transaksione që lidhen me pasuritë e luajtshme dhe ato të paluajtshme, si dhe çdo veprimtari financiare, qiradhënie ose hipotekimi e cila mund të konsiderohet e dobishme ose e nevojshme për përmbushjen e qëllimit të shoqërisë. Bashkëpunon ose/dhe blen në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë interesa në shoqëri, agjensi, apo ndërmarrje të tjera, pavarësisht objektit të veprimtarisë së këtyre të fundit, gjithashtu merr pjesë në Joint Ventures apo nënshkruan marrëveshje të ngjashme, me shoqëri të tjera që kanë objekt të njëjtë apo të ngjashëm.

Kategoritë e subjekteve të të dhënave personale, të cilëve ky kontrollues ju përpunon të dhëna personale janë: *punëmarrës, anëtarë të asamblesë, aksionerë dhe klientë.*

Kategoria më e rëndësishme në kuptim të sasisë së të dhënave personale që përpunohen është kategoria e subjekteve "Klientë". Gjatë kontrollit të ushtruar nga grupi i kontrollit të Zyrës së Komisionerit u konstatua se, kontrolluesi mbledh, përpunon, ruan të dhëna personale në rrugë manuale, nëpërmjet krijimit të dosjeve fizike, për subjektet e të dhënave personale individë/klientë dhe punonjës dhe në rrugë elektronike.

Subjektet të cilët nuk janë regjistruar me dëshirën e tyre në sistem **mund të kontaktohen pa dhënë pëlqimin e tyre paraprak për një komunikim të tillë.**

Mbasi regjistrohen në sistem si " *klientë të mundshëm/potencial*", subjektet e të dhënave kontaktohen nëpërmjet shërbimit të telefonisë nga stafi i kontrolluesit . . . . Konstatohet se, subjektet e të dhënave të cilët kontaktohen nëpërmjet telefonisë **nuk informohen lidhur me regjistrimin e bisedës së realizuar** gjatë telefonatës.

Grupi i kontrollit administroi si prova materiale, printime të ndërfaqes së këtij sistemi, me qëllim identifikimin e kategorive të të dhënave të klientëve si dhe proceseve të këtij sistemi.

Kategoritë e të dhënave personale të subjekteve të të dhënave janë:

- Emër/Mbiemër;
- Datëlindje;
- Datën e regjistrimit;
- Telefon;
- E-mail;
- Statusi i regjistrimit;
- Përkatësi fetare (islamik);
- Adresa e fundit e protokollit të internetit që është lokalizuar për herë të fundit;
- Të ardhura personale (përafërsisht dhe me vetëdeklarim);
- Të dhëna të tjera të cilat mund të ofrohen nga vet " *klienti*";

Në momentin e ushtrimit të kontrollit administrativ, në sistem u konstatuan **10.768 " *klientë*"** në total, një potencial i konsiderueshëm të dhënash personale, të cilat grumbullohen, ruhen dhe përpunohen.

Grupi i kontrollit konstatoi se nëpërmjet sistemit mund të realizohen filtrime sipas fushave të sistemit psh.:

- Numri i Identifikimit;
- Data e krijimit;
- Qyteti;
- Statusi i regjistrimit;
- Depozita totale;
- Listë e zezë;
- Islamik apo jo;
- Vendndodhja ;
- Adresa e pajisjes kompjuterike IP (internet protokoll):

Nga kontrolli i ushtruar pranë kontrolluesit u administruan në cilësinë e provës, biseda telefonike, (në formatin " *gsm*"), të administruara nga sistemi, " *. . . . .*", i cili shërben për realizimin e komunikimit të punonjësve të kontrolluesit me " *Klientët e mundshëm*". Bisedat e regjistruara në

sistem mund të interceptohen nëpërmjet aplikacionit VLC Media Player. Disa nga regjistrimet në formatin ".gsm" të administruara nga grupi i kontrollit janë:

- out-0682031514 .6908 (1).gsm;
- out-0693061619 .6872.gsm;
- out-0039335130 7899.7427.gsm;
- printim nga ndërfaqja e sistemit PBX;

Nga kontrolli i ushtruar rezultoi se kontrolluesi nuk ka rregulla në lidhje me identifikimin e kategorisë së subjekteve të të dhënave "klient". Identifikimi i subjekteve të të dhënave "klient" dhe marrëdhëniet me palët e treta realizohet në mënyra jo të përcaktuara qartë dhe të pa mbështetur në dokumenta ligjore konkrete duke realizuar në këtë mënyrë përpunim jo të drejtë dhe jo të ligjshëm të të dhënave personale. Kontrolluesi nuk vendosi në dispozicion të grupit të kontrollit administrativ asnjë dokumentacion që të legjitimonte këtë përpunim të dhënash personale.

Nga kontrolli i ushtruar u konstatua se një kategori tjetër përpunimi të dhënash është, "*Mbikëqyrja e ambienteve të punës*", nëpërmjet "*Sistemit të Video Survejimit*". Gjithashtu, gjatë përpunimit të të dhënave me anë të sistemit CCTV u konstatua se, kontrolluesi nuk kishte marrë masa për informimin e subjekteve të të dhënave nëpërmjet, "*tabelave informuese*". Kontrolluesi nuk ka një dokument të shkruar për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë e të dhënave si dhe informimin e subjekteve të të dhënave nëpërmjet "*Sistemit të Video Survejimit*".

Kontrolluesi "Stock International Albania" sh.a., nuk kishte përmbushur detyrimin ligjor, që rrjedh nga neni 21 dhe 22 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, për depozitimin e Formularit të Njoftimit, pranë Autoritetit të Komisionerit.

Kontrolluesi "Stock International Albania" sh.a. nuk dispononte një rregullore të posaçme për mbrojtjen e të dhënave personale, ku të përcaktohen qartë rregulla për mbledhjen, përpunimin, mbrojtjen e të dhënave personale, kohën e ruajtjes, procedurat e asgjësimit, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave, duke rënë ndesh me nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar.

Kontrolluesi "Stock International Albania" sh.a., nuk realizon detyrimin për informim të subjektit të të dhënave personale, (në momentin e kontaktimit telefonik, regjistrimin e bisedës së realizuar dhe ruajtjen e përmbajtjes së saj, etj), dhe nuk zbaton mekanizmin e marrjes së pëlqimit me shkrim për subjektet e të dhënave personale të kategorisë "*klient*", duke cënuar të drejtën e ligjshme të individit, të parashikuar në nenin 18 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar. Gjithashtu, kontrolluesi ka të publikuara, "*Politikat e Privatësisë*", në faqen online të tij, por këto politika, nuk janë në përputhje dhe nuk reflektojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar.

Kontrolluesi "Stock International Albania" sh.a., realizon shkëmbim të dhënash personale, (emër, mbiemër, dokumente të skanuara etj), nëpërmjet platformës elektronike që ka në përdorim me kompaninë mëmë, ACECAP Investment Limited, në Qipro, pa patur një akt/dokument ndërmjet palëve, që të legjitimojë shkëmbimin e informacionit personal, sipas dispozitave të legjislacionit shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale, duke shkelur kështu, nenin 8 dhe 20 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar.

Kontrolluesi, nuk ka rregulla, në lidhje me përpunimin e të dhënave të kategorisë "klient", mënyra si i siguron këta klientë, marrëdhëniet me palët e treta, realizohet në rrugë të paqartë dhe të pambështetura në dokumenta ligjore konkrete, duke realizuar në këtë mënyrë, përpunim jo të drejtë dhe jo të ligjshëm të të dhënave personale për këtë kategori. Kontrolluesi nuk vendosi në dispozicion të grupit të kontrollit administrativ asnjë dokumentacion që të legjitimonte këtë përpunim të dhënash personale. P.sh:

-Deklarimet e bëra nga përfaqësuesit e kontrolluesit se këto të dhëna merren nga Regjistrat publikë, si regjistrat e QKR, QKI, etj, rezultojnë të pambështetura në prova, sepse në bazë të provave të mbedhura gjatë kontrollit administrativ, rezultoi që një pjesë e subjekteve të cilëve iu përpunoheshin të dhënat personale nuk ishin pjesë e këtyre regjistrave;

-Deklarimet e përfaqësuesit të kontrolluesit se, të dhënat siguroheshin nga njohjet personale të punonjësve, nga kontaktet personale apo indirekte me subjektet e të dhënave, në kuadër të ligjit përbëjnë përpunim jo të ligjshëm përderisa janë realizuar pa evidentimin e marrjes së pëlqimit nga subjektet e të dhënave personale;

- Në politikat e privatësisë të kontrolluesit, referohet se: "*Kompania mbledh informacion nga klientët dhe mund në rrethana të caktuara, të mbledhë informacion nga bankat dhe ose agjencite e kreditimit dhe/ ose burime që ndihmojnë kompaninë të krijojë profilin e klientit bazuar në preferencat e tyre*". Nga kontrolluesi nuk u vu në dispozicion asnjë dokumentacion që të legjitimonte këtë proces, (kontratë, marrëveshje etj), ku të reflektohej edhe informimi dhe marrja e pëlqimit të klientit në lidhje me këtë proces, (potencialisht), shkëmbimi dhe përdorimi i informacionit midis palëve, etj.

Pra, u konstatua një grumbullim të dhënash personale të subjekteve në mënyrë të jo të ligjshme, duke shkelur parimet bazë të mbrojtjes së të dhënave personale, dhe konkretisht parimet e parashikuara në nenet 5-6 të të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar. Të gjitha këto shkelje janë evidentuar në procesverbalin e kontrollit administrativ të datës 22.12.2014 i nënshkruar rregullisht nga palët.

Përfaqësuesja e kontrolluesit "Stock International Albania" sh.a, nuk parashtroi pretendime të atypëratyshme lidhur me konstatimet në procesverbalin e kontrollit administrativ, por kërkoi kohë në dispozicion, rreth konstatimeve të nxjerra nga grupi i kontrollit, sipas procesverbalit në fjalë.

Nga zyra e Komisionerit u la koha e nevojshme në dispozicion dhe në zbatim të neneve 93-96 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", pasi është njoftuar pala paraprakisht, në ambientet e Zyrës së Komisionerit në datën 19/01/2015, është zhvilluar seanca dëgjimore në praninë e përfaqësuesve të kontrolluesit, të cilën paraqitën kërkesën për shtyrjen e seancës dëgjimore, kërkesë e cila u morr parasysh nga Komisioneri dhe u la një takim i dytë i cili u zhvillua në datën 20/01/2015. Përfaqësuesja e kontrolluesit, "Stock International Albania", u paraqit në seancën dëgjimore, që u zhvillua pranë ambjentëve të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ku paraqiti dhe pretendimet me shkrim. Në këto pretendime nuk u kundërshtuan shkeljet e konstatuara dhe u paraqitën arsye, si fakti që kontrolluesi është një biznes i ri në treg dhe vështirësitë në mënyrën e adaptimit në lidhje me marrjen e një licensë të përshtatshme për veprimtarinë që realizohet.

Pretendimet e kontrolluesit kanë qënë në kuadrin deklarativ dhe nuk janë paraqitur prova konkrete për marrjen e masave, në përmbushje të detyrimeve ligjore. Gjithashtu, mospërcaktimi i llojit të licencës nuk legjitimon shpërdorimin, keqpërdorimin, abuzimin me të dhënat personale të subjekteve.

Aktiviteti rezulton të realizohet në mënyrë të jashtëligjshme dhe përpunimi i të dhënave personale rezulton të bëhet në mënyrë jo të drejtë dhe jo të ligjshme, duke mosrespektuar dispozitat dhe duke qënë në shkelje të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Në këto kushte, për shkak të shkeljeve të konstatuara dhe zhvillimit të aktivitetit në mënyrë të paligjshme në këndvështrim të dispozitave të ligjit, Zyra e Komisionerit me anë të Urdhrit nr. 01, datë 05/02/2015 urdhëroi, kontrolluesin “Stock International Albania” sh.a:

- ✚ Të realizojë në mënyrë të menjëhershme pezullimin e përpunimit të të dhënave personale, kategoria ,“klientë”.
- ✚ Kryerjen e seleksionimit të të dhënave për kategorinë e subjekteve, klasifikimin dhe verifikimin e saktë të tyre, si të dhëna të mbledhura në mënyrë të ligjshme dhe në mënyrë jo të drejtë dhe të ligjshme.
- ✚ Të realizohet shkatërrimi i të dhënave personale, të siguruara në mënyrë jo të drejtë dhe të ligjshme , brenda një afati 7(shtatë) ditor.
- ✚ Të njoftojë zyrën e Komisionerit për zbatimin e detyrimeve të lëna në urdhër.

Kontrolluesi nuk njoftoi zyrën e Komisionerit në lidhje me zbatimin e detyrave të lëna me anë të Urdhrit të detyrueshëm për zbatim. Në këto kushte, në përmbushje të detyrave funksionale, me anë të Udhërit të dytë, nr.23, datë 19/02/2015 zyra e Komisionerit realizoi verifikimin pranë kontrolluesit të zbatimit të këtij urdhri. Pas përfundimit të inspektimit administrativ rezultoi që kontrolluesi nuk kishte përmbushur asnjë nga detyrimet e lëna në urdhër. Të gjitha konstatimet e grupit të kontrollit u pasqyruan në procesverbalin e inspektimit administrativ të datës 19/02/2015 i cili ju bë i njohur kontrolluesit dhe u nënshkrua rregullisht nga palët. Përfaqësuesja e kontrolluesit, në lidhje me konstatimet e grupit të kontrollit të pasqyruara në procesvebal u shpreh se, citojmë:

Nga provat e mbledhura nga inspektimi administrativ pranë kontrolluesit u konstatua, se ky i fundit jo vetëm që nuk kishte përmbushur asnjë nga pikat e urdhrit po kishte vazhduar aktivitetin duke shtuar numrin e klientëve, i cili nga **10.768 “klientë”** në kontrollin e parë të ushtruar ishte shtuar në **16.315 “klientë”**. Nuk ishte bërë një seleksionim apo shkatërrim i të dhënave dhe është vazhduar me kontaktimin e personave. Për këtë u administruan në cilësinë e provës edhe regjistrime audio, me persona pas lëshimit të urdhërit. Kontrolluesi, në datën 03/03/2015 administruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 8/5 prot, ka paraqitur disa observacione ku informon se ka filluar procesi i seleksionimit total të gjithë subjekteve të kategorisë “klientë” dhe ka deklaruar se ka filluar procesi i hartimit të rregulloreve të brendshme në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale sipas konstatimeve të grupit të kontrollit. Por, përsëri të gjitha deklaratimet e palës mbetën në kuadrin deklarativ dhe nuk u paraqit asnjë provë konkrete në mbështetje të deklaratimeve. Për më tepër, kontrolluesi ka vazhduar me kontaktimin e subjekteve të të dhënave personale, edhe pas datës 03/03/2015. Në datën 11/03/2015 është kontaktuar me shtetasin me iniciale J.S, i cili ka paraqitur edhe një ankesë pranë Zyrës së Komisionerit. Nga verifikimet e

kryera i vetmi detyrim ligjor i përmbushur nga kontrolluesi është detyrimi i njoftimit në zbatim të nenit 21 të ligjit, administruar me nr. 94 prot, datë 26/01/2015.

Si përfundim, në kuptim të nenit 39 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit administrativ, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, përbëjnë "**kundërvajtje administrative**" dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

- Kontrolluesit ose përpunuesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II, "Përpunimi i të dhënave personale", të përcaktuara përkatësisht në nenet 5, 6, 7, dhe 8 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 500 000 lekë.
- Kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë.
- Kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë.

Kontrolluesi është person juridik dhe bazuar në nenin 39/2 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, personat juridikë, për kundërvajtjen e mësipërme, dënohen me dyfishin e gjobës.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Komisioneri ka parasysh duke parë me shqetësim gamën e gjerë të shkeljeve, të një numri të madh klientësh, duke cënuar rëndë të drejtën e individit, në mbrojtjen e investimit të tij jetik, në të dhënat personale. Shkeljet e konstatuara janë serioze, pasi lidhen me të drejta të rëndësishme të subjektit të të dhënave, për të pasur një përpunim të ligjshëm të të dhënave personale nga kontrolluesi, i cili detyrohet të garantojë dhe respektojë privatësinë e individit.

### PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 5, 6, 8, 18, 20, 27, 28, 29, 30, 39/1/a, 39/1/b, 39/1/dh, 39/2, 40, 41 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të Ligjit Nr.8485, datë 12.05.1999, "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*",

### V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit "**Stock International Albania**" sh.a. me gjobë, në vlerën **100 000** (njëqind mijë) lekë për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në kreun II, "Përpunimi i të dhënave personale" të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.
2. Dënimin e kontrolluesit "**Stock International Albania**" sh.a. me gjobë, në vlerën **30 000** (tridhjetë mijë) lekë për shkelje të detyrimit të përcaktuar në **nenin 18** të të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.
3. Dënimin e kontrolluesit "**Stock International Albania**" sh.a. me gjobë, në vlerën **20 000** (njëzetë mijë) lekë për shkelje të detyrimit të përcaktuara në **nenet 27 dhe 28** të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.

4. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30(tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit.

Ky vendim u shpall sot më datë 18/03/2015.

